

A jeni grua e papunë, e re, ose anëtare e komuniteteve të cënueshme në Kosovë që kërkon një të ardhme më të mirë?

A keni një ide biznesi në bujqësi?

Aplikoni tani për trajnim dhe mentorim FALAS në agrobiznes!

Projekti *“Përforcimi i komuniteteve të cënueshme përmes zhvillimit të aftësive në Agrobiznes dhe Energji Diellore”* ka si qëllim mbështetjen e individëve të papunë dhe anëtarëve të grupeve të cënueshme në Kosovë duke i pajisur ata me njohuri praktike në agrobiznes dhe instalimin e paneleve solare. Përmes trajnimeve të përshtatura dhe udhëzimeve praktike, iniciativa promovon vetë-punësimin dhe forcon mundësitë për krijimin e të ardhurave, duke ndihmuar pjesëmarrësit të kthejnë idetë e tyre në mundësi të qëndrueshme jetese.

Nëpërmjet këtij projekti, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Kosova – Women 4 Women, dhe me mbështetje nga **Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)** përmes GIZ Kosova, shpallin thirrje publike për individë të papunë nga grupe të cënueshme. Gratë, të rinjtë, komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptian, banorët e zonave rurale dhe të rikthyerit nga shtetet perendimore, që dëshirojnë të fillojnë një agrobiznes, ftohen të aplikojnë për trajnimin interaktiv pesëditor “Si të filloni dhe menaxhoni një Agrobiznes,” i cili do të pasojë me një program individual mentorimi për tre muaj. **Pjesëmarrësit do të përfitojnë udhëzime profesionale, vizita në terren në biznese të suksesshme bujqësore, mbështetje në zhvillimin e planeve të biznesit dhe informacion mbi mundësitë e financimit (grante, kredi, konkurse).** Transporti dhe ushqimi do të mbulohen plotësisht.

Kush mund të aplikojë?

Programi është i dizajnuar **për gratë, të rinjtë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, banorët e zonave rurale dhe të rikthyerit nga shtetet perendimore** të cilët kanë një ide të qëndrueshme biznesi dhe dëshirojnë të fillojnë agrobiznesin e tyre. Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë të regjistruar si të papunë në Zyrën e Punësimit në komunën përkatëse
- T’i përkasin njërit nga grupet e cënueshme të synuara (p.sh. gra, të rinj nga zonat rurale apo grupe minoritare)
- Të mos kenë përfituar nga ndonjë masë e ofruar nga Agjencia e Punësimit apo programe nga donator tjerë gjatë vitit të fundit
- Të jenë në moshën nga 18 deri në 55 vjeç
- Të shprehin interes për të filluar ose menaxhuar një agrobiznes
- Të jenë të gatshëm të marrin pjesë fizikisht në programin e trajnimit
- Të jenë të gatshëm të ndjekin mentorimin deri në 3 muaj
- Të kenë aftësi bazike të leximit dhe shkrimit

Çfarë ofron trajnimi?

- **Trajnim interaktiv 5-ditor** për agrobiznes;
- **Vizitë njëditore në terren** në një agrobiznes të suksesshëm;
- **Deri në 3 muaj mentorim**, që përfshin udhëzime për mundësitë e financimit (grante, kredi, konkurse), shkrimin e projekteve dhe mbështetje për zhvillimin e biznesit;
Shënim: Ky program nuk ofron grante direkte.
- **Transporti dhe ushqimi** do të mbulohen nga programi.

Kriteret e përzgjedhjes

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Aplikanti duhet të jetë banor i njërës nga komunat e mëposhtme sipas grupit¹ të trajnimit:
 - ❖ **Grupi 1 – Lokacioni i trajnimit: Prishtinë**
I hapur për aplikantë nga komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Drenas (Glogoc), Lipjan dhe Graçanicë.
 - ❖ **Grupi 2 – Lokacioni i trajnimit: Prizren**
I hapur hapur për aplikantë nga komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Mamushë dhe Dragash.
 - ❖ **Grupi 3 – Lokacioni i trajnimit: Gjakovë**
I hapur për aplikantë nga komunat: Gjakovë, Rahovec, Deçan dhe Junik.
- Aplikanti duhet të jetë i regjistruar si i papunë në Zyrën e Punësimit.
(Shënim: Përparësi do t'u jepet personave të papunë afatgjatë)
- T' i përkasë një grupi të cënueshm. Aplikanti duhet të jetë pjesë e të paktën njërës nga grupet e mëposhtme:
 - Gra (mosha 18–55)
 - Të rinj (mosha 18–29)
 - Komunitetet rom, ashkali ose egjiptian
 - Banorë të zonave rurale
 - Të rikthyerit nga shtetet perendimore
(Shënim: Përparësi do t'u jepet personave që janë të rikthyer)
- Aplikanti duhet të shfaqë interes për të filluar ose menaxhuar një agrobiznes, të jetë i gatshëm të marrë pjesë personalisht në të gjitha sesionet e trajnimit dhe të ndjekë programin e mentorimit deri në 3 muaj.

Dokumentet e Nevojshme për Aplikim:

1. **Formulari i Aplikimit** – duhet të plotësohet në tërësi dhe të nënshkruhet (obligative)
2. **Deklaratë e Papunësisë** – e lëshuar nga Zyra e Punësimit (obligative)
3. **Dokumentacioni që vërteton statusin e të kthyerit nga migrimi** – nëse aplikohet

Shënim: Çdo aplikacion që nuk është plotësuar në tërësi ose që nuk përfshin të gjitha dokumentet e kërkuara, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në shqyrtim.

¹ Numri maksimal i pjesëmarrëseve të përzgjedhur për secilin grup të trajnimit do të jetë 20.

Si të aplikoni?

Formulari i aplikimit mund të plotësohet online ose në zyrat e punësimit në Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Drenas (Glllogoc), Lipjan, Graçanicë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Mamushë, Dragash, Gjakovë, Rahovec, Deçan dhe Junik deri më **22.08.2025 në ora 16:00**.

Aplikimi online:

Plotësoni formularin online dhe bashkëngjitni të gjitha dokumentet e kërkuara në format PDF.

Aplikimi në zyrat e punësimit:

Shkarkoni pakon e aplikimit online ose kërkojeni atë në zyrën lokale të punësimit. Pastaj, plotësoni dhe dorëzoni dokumentet e kërkuara fizikisht në njërin nga këto zyra të punësimit, sipas komunës suaj: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Drenas (Glllogoc), Lipjan, Graçanicë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Mamushë², Dragash, Gjakovë, Rahovec, Deçan ose Junik.

Shënim: Për shkak të numrit të madh të aplikimeve, do të zbatohet parimi "i pari që aplikon i pari shërbehet"!

Për pyetje shtesë rreth aplikimit apo trajnimit, ju lutem kontaktoni: info@k-w4w.com ose +383 48 450 360

² Aplikantët nga komuna e Mamushës mund ta dorëzojnë aplikacionin fizikisht në zyrën e punësimit në Suharekë